



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 19.04.2023

Nr: 61

Ora: 16:30

VENDIM

PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS ANKIMORE NR. 50, DATË 17.04.2023, DEPOZITUAR NGA “PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 19.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Koli BELE	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

ANKUES: “Partia Demokratike e Shqipërisë”, përfaqësuar nga z. Indrit Sefa;

PALË E INTERESUAR: Koalicioni “Bashkë Fitojmë”, përfaqësuar nga z. Altin Kaziaj dhe z. Franc Nuri

OBJEKT:

1. Shfuqizimi i vendimit nr. 361, datë 15.04.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për Këshillin e Bashkisë Tiranë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

2. Shfuqizimi i vendimit nr. 362, datë 15.04.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në Këshillat Bashkiak në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

3. Ndryshimi i përmbajtjes së fletës së votimit, duke vendosur të gjitha kërkesat e përcaktuara në nenin 98, pika 3 e Kodit Zgjedhor sipas propozimit bashkëlidhur.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21/b dhe 123/1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Rrethanat e çështjes:

1. Në seancën publike të datës 15.04.2023, me vendimet nr. 361 dhe nr. 362, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve vendosi miratimin e fletëve të votimit për kandidatët për anëtarë të këshillave bashkiakë në 61 bashki.
2. Kundër këtyre vendimeve ka paraqitur kërkesë ankimore “Partia Demokratike e Shqipërisë”, e cila ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 361, datë 15.04.2023 “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për këshillin e Bashkisë Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023” ; shfuqizimin e vendimit nr. 362, datë 15.04.2023 “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në Këshillat Bashkiak në 60 bashki për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”, si dhe ndryshimin e përmbajtjes së fletës së votimit, duke kërkuar plotësimin e kritereve të nenit 98, pika 3 të Kodit Zgjedhor sipas një propozimi bashkëlidhur.

3. Kërkesa ankimore nr. 50 iu paraqit KAS-it, i cili vendosi pranimin për shqyrtim të saj me relator z. Koli Bele. KAS-i caktoi seancën e shqyrtimit në datën 19.04.2023, ora 16:30. Në seancë ishin të pranishëm administrata e KQZ-së, përfaqësuar nga Sekretari i Përgjithshëm z. Ylli Merkaj, pala ankimuese z. Indrit Sefa, si dhe përfaqësuesit e koalicionit “Bashkë Fitojmë” z. Altin Kaziaj dhe z. Franc Nuri.
4. Ankuesi “Partia Demokratike e Shqipërisë” pretendoi se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka shkelur dispozitat e përcaktuar në nenin 98, pikën 3, të Kodit Zgjedhor, duke mbajtur qëndrim të kundërt me praktikën e përcaktimit të fletës së votimit në zgjedhjet e vitit 2021, duke shkaktuar konfuzion te zgjedhësit për identifikimin e qartë të subjekteve zgjedhore garuese në zgjedhje. Përfaqësuesi z. Sefa shprehu se dy prej subjekteve zgjedhore, që janë dhe koalicione nuk përmbushin përcaktimet ligjore të nenit 98, pika 3 e Kodit Zgjedhor, pasi përbri subjektit zgjedhor duhet vendosur sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë drejtuese. Pasi iu referua dhe vendimit nr. 5, datë 04.04.2023 të Kolegjit Zgjedhor theksoi se koalicioni si subjekt zgjedhor duhet të vendosë emrin e kryetarit të partisë udhëheqëse në fletën e votimit, njësoj si parti të politike.
5. Në seancën publike të shqyrtimit administrativ, mori pjesë si palë e interesuar koalicioni “Bashkë Fitojmë”, i cili prapësoi pretendimet e ankuesit, duke shpjeguar se nuk ka vend për konfuzion te zgjedhësit, përse kohë koalicioni “Bashkë Fitojmë” nuk ka emblemë të ngjashme me “Partinë Demokratike të Shqipërisë”. Pajisja me një emër ose jo në fletën e votimit nuk përbën disavantazh, pasi është vetë koalicioni, me anë të marrëveshjes që vendos, se kë emër propozojnë. Me anë të shkresës nr. 367 prot., datë 19.04.2023 të depozituar nga z. Endrit Braimllari, paraqitën vullnetin e koalicionit “Bashkë Fitojmë” për të vendosur emrin e deputetit z. Sali Berisha përbri emrit të koalicionit, si deputet i pavarur në raport me të gjitha parti të përbërëse të koalicionit.
6. Sekretari i Përgjithshëm i KQZ-së, po ashtu prapësoi se kërkesa ankimore është e pabazuar në ligj dhe në prova, duke kërkuar rrëzimin e saj dhe lënien në fuqi të vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
7. KAS-i mori në shqyrtim dhe administroi:
 - Kërkesa ankimore nr. 50, datë 17.04.2023
 - Vendimi nr. 361, datë 15.4.2023, “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për këshillin e Bashkisë Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”

- Vendimi nr. 362, datë 15.4.2023, “Për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit për kandidatët për anëtar në këshillat bashkiak në 60 bashki, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”
- Vendimi nr. 19 i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve, datë 03.04.2021 “Për shqyrtimin e kërkesave ankimore nr. 08 të Partisë Socialiste të Shqipërisë, nr. 09 të Partisë Bindja Demokratike dhe nr. 10 të koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim (PD-AN) ndaj vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 198, datë 01.04.2021”
- Shkresa e përfaqësuesit “Bashkë Fitojmë” z. Endrit Braimllari, nr. 367 prot., datë 19.04.2023
- Kërkesa nr. 143 prot., datë 15.03.2023 nga z. Endrit Braimllari depozituar në KQZ, e bashkangjitur marrëveshja për krijimin e koalicionit “Bashkë Fitojmë”
- Fleta e votimit e datës 25.04.2021
- Procesverbali i zbardhur i seancës publike të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, datë 15.04.2023
- Kërkesa nr. 3/11 prot., datë 13.03.2023 e Aleancës Liberale të Djathtë me dokumentacionin shoqërues
- Kërkesa nr. 1482 prot., datë 24.02.2021 për regjistrimin e koalicionit Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim
- Vendimi nr. 5, datë 04.04.2021 i Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor.

Në përfundim të shqyrtimit administrativ dhe të vlerësimit të provave dhe pretendimeve të palëve,

KAS-i konstatoi :

1. Vendimet e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 361 dhe nr. 362 të datës 15.04.2023 kanë miratuar përmbajtjen e fletës së votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë Tiranë dhe për këshillat bashkiakë të 60 bashkive të tjera, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023. Vendimet nuk përmbajnë arsyetimin pse nuk është marrë në konsideratë kërkesa e ankuesit që përbri emrit të koalicioneve të shënohet emri i kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit përkatës, por nga rileximi i debatit të seancës publike rezulton se Komisioneri ka gjykuar se për koalicionet duhet lënë në diskrecionin e vetë këtyre subjekteve,

nëse duan t'a pasqyrojnë emrin e kryetarit të partisë udhëheqëse të përfshirë në fletën e votimit apo jo.

2. Si organ publik, Komisioneri është i pajisur me pushtet diskrecial. Sipas Kodit të Procedurave Administrative, *“diskrecioni i organit publik” është e drejta e këtij të fundit për të ushtruar autoritet publik për të përmbushur një qëllim të ligjshëm, në rastet kur ligji parashikon pjesërisht modalitetet për të arritur këtë, duke i dhënë hapësirë vlerësimi zgjedhjeve të organit publik (pika 3 e nenit 3 të K.Pr.Administrative). Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 11 të tij, ka përcaktuar saktësisht kufijtë e ushtrimit të pushtetit diskrecial, duke parashikuar se:*

“Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

- a) është i parashikuar me ligj;*
- b) nuk tejkalon kufijtë e ligjit;*
- c) zgjedhja e organit publik është bërë vetëm për të arritur objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni dhe është në përputhje me parimet e përgjithshme të këtij Kodi; dhe*
- ç) zgjedhja nuk përbën një shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme”.*

4. Kolegji Zgjedhor, në vendimin e tij nr. 5, datë 04.04.2021, pasi ka konfirmuar të drejtën e Komisionerit për diskrecion në kompozimin e fletës së votimit, ka njohur faktin se *“organet e ankimit duhet të respektojnë diskrecionin e Komisionerit, sa kohë që nuk provohet qartazi se zgjedhja e Komisionerit është në kundërshtim me ligjin dhe dëmton rëndë procesin zgjedhor”.*
5. Ky kontekst kërkon që shqyrtimi i ankimit nga KAS-i të jetë strikt shqyrtim ligjshmërie. KAS-i duhet të shqyrtojë dhe të vendosë nëse vendimi i Komisionerit për t'a lënë në zgjedhje të përfaqësuesve të koalicioneve vendimin për të pasqyruar ose jo në fletën e votimit emrin e kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit është brenda të drejtës së tij për diskrecion, apo jo, sikurse duhet të verifikojë, nëse diferencimi në fletën e votimit i koalicioneve nga subjektet e tjera është brenda kompetencës së Komisionerit, apo jo. Preferencat e KAS-it për përmbajtjen e fletës së votimit janë irelevante në trajtimin e kësaj çështje, prandaj nuk do jenë objekt i shqyrtimit dhe vendimmarrjes së KAS-it.

6. Pyetja e parë e rëndësishme lidhur me pushtetin diskrecial të Komisionerit është se a është i parashikuar me ligj diskrecioni për Komisionerin në rastin kur ai miraton përmbajtjen e fletës së votimit?

Nga analiza ligjore e çështjes (shih vendimin e KAS-it nr. 19, datë 03.04.2021) KAS-i konstaton se Kodi Zgjedhor ka vendosur hapësirë diskreciale për KQZ-në në çështjen e formatimit të fletës së votimit. Kjo hapësirë diskreciale bëhet e nevojshme për shkak se numri i subjekteve pjesëmarrëse mund të ndryshojë shumë nga një zgjedhje në tjetrën. Por Kodi, bashkë me diskrecionin, i ka caktuar KQZ-së kufij të pakapërcyeshëm dhe të palëvizshëm. Këto kufij kanë të bëjnë me:

- fleta e votimit duhet të jetë me ngjyrë dhe formë të njëjtë për të gjitha zonat zgjedhore (neni 97, pika 1);*
- fletët e votimit duhet të jenë prej letre, me ngjyrë, trashësi ose elemente konfigurimi të tilla që të mos lejojnë leximin e votës në pjesën e pasme të saj, si dhe të përmbajnë elemente sigurie (neni 98, pika 1);*
- emrat e subjekteve zgjedhore duhet të vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. **Përbri emrit të partisë duhet të vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë (neni 98, pika 3);***
- çdo subjekti që renditet në fletën e votimit duhet t'i korrespondojë hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi (neni 98, pika 3).*
- fleta e votimit për zgjedhjet për Kuvendin duhet të përmbajë hapësirën e posaçme për ushtrimin e votimit parapëlqyes për kandidatët e subjektit zgjedhor (neni 98, pika 4).*

7. Pyetja e dytë në këtë pikë është se a është e ligjshme të delegohet tek të tretët (tek palët e procedurës administrative) diskrecioni i organit publik? Diskrecioni është metodë e ushtrimit të autoritetit publik, metodë vendimmarrjeje. **Diskrecioni nuk delegohet tek palët, sepse vendimmarrja nuk delegohet tek palët.** Nëse vendosja e emrit të kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit është çështje e diskrecionit të Komisionerit, atëherë vendimin për këtë duhet t'a marrë Komisioneri, kurrsesi përfaqësuesi i koalicionit zgjedhor pjesëmarrës në garë. **Ky**

delegim kompetence është i paligjshëm. Vendimmarrja që pranon këtë delegim është e paligjshme.

8. Pyetje tjetër e rëndësishme në analizën e pushtetit diskrecial është se a është zgjedhja e bërë nga Komisioneri në përputhje me objektivin për të cilin është lejuar diskrecioni?

Objektivi në kompozimin e fletës së votimit është që të hartohet një fletë votimi që e bën sa më të qartë ofertën dhe alternativat konkurruese, që shmang mundësitë e konfondimit të zgjedhësve dhe që e bën sa më të thjeshtë votimin dhe sa më të kuptueshëm vullnetin e zgjedhësve. KAS-i është shprehur edhe në vendimin e tij nr. 19, datë 03.04.2021 se *“sa i përket kompozimit të fletës së votimit, interesi i zgjedhësve është interes madhor në raport me interesin e subjekteve zgjedhore dhe të kandidatëve të tyre. Fleta e votimit nuk është në shërbim të subjekteve dhe kandidatëve, por është në shërbim të drejtpërdrejtë të zgjedhësve ... Interesat e subjekteve dhe të kandidatëve të tyre nuk janë domosdoshmërisht në harmoni me interesin e votuesve në këtë pikë ... Për këtë arsye, KQZ-ja nuk mund të vendosë si objektiv konsensusin publik apo midis subjekteve zgjedhore kur kompozon fletën e votimit, por duhet të kujdeset që të plotësojë pa kompromis nevojat e votuesve për fletë votimi të thjeshtë, të qartë, të kuptueshme dhe të lehtë në orientim”.*

9. Koalicionet zgjedhore janë krijesa politike, në përgjithësi, jetëshkurtra. Ato janë aleanca politike që farkëtohen në harkun e një procesi zgjedhor dhe që, si rregull, shpërbëhen pas zgjedhjeve. Këtu e ka burimin interesi i fortë elektoral për përdorimin tek koalicionet të të gjithë gamës së instrumenteve identifikues, më shumë se për partitë politike tradicionale, të cilat njihen dhe identifikohen lehtësisht edhe vetëm nga logoja, shkronjat nistore apo emri i kryetarit. **Duke përdorur gjithë gamën e instrumenteve identifikues për koalicionet, rritet besimi dhe siguria se zgjedhësit do ta kenë më të lehtë t’a dallojnë dhe identifikojnë koalicionin në morinë e subjekteve garuese.** Interesi i përfaqësuesve të palës së interesuar për të shmangur emrin e kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit “Bashkë Fitojmë” nga përfshirja në fletën e votimit nuk shpjegohet me nevojën dhe interesin e zgjedhësve për transparencë e qartësi. **Një instrument identifikues më pak, do të thotë më pak qartësi për zgjedhësit.**

10. Me vendimmarrjen e tij, Komisioneri e ka trajtuar çështjen e vendosjes ose jo të emrit të kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit në fletën e votimit si çështje që i përket vetëm interesave të

koalicionit përkatës dhe, me këtë, i është kundërvënë objektivave të vendimmarrjes institucionale. Komisioneri duhet të kishte arsyetuar nëse i bën mirë apo keq zgjedhësve përfshirja e emrit të kryetarit të partisë (ose të partisë udhëheqëse) në fletën e votimit, ose, më saktë, të shpjegonte pse, në çmimin e tij, pasqyrimi në fletën e votimit i emrit të kryetarit të partisë u bën mirë zgjedhësve, kurse pasqyrimi i emrit të kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit u bën keq atyre.

11. Lidhur me kushtin që zgjedhja të mos përbëjë shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme, KAS-i pranon arsyetimin dhe provat e paraqitura nga ankuesi lidhur me praktikën e zgjedhjeve të vitit 2021. KAS-i çmon se devijimi nga vendimmarrja e mëparshme përbën shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga Komisioneri në zgjedhjet e vitit 2021.
12. Lidhur me kushtin për mostejkalimin e kufijve të ligjit me ushtrimin e pushtetit diskrecial pyetja që shtrohet është se a është detyruese, sipas Kodit Zgjedhor, përfshirja e emrit të kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit në fletën e votimit, apo Komisioneri është i lirë t'a vendosë si e gjykon të arsyeshme?

Pika 3 e nenit 98 të Kodit Zgjedhor përcakton se *“emrat e subjekteve zgjedhore vendosen në fletën e votimit, sipas rendit të përcaktuar në mënyrë të rastësishme nga shorti. **Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë.** Çdo subjekti që renditet në fletën e votimit i korrespondon hapësira përkatëse për shënimin e votës nga zgjedhësi”*. Fjalja e dytë është e vlefshme si për partitë politike që garojnë më vete, ashtu dhe për koalicionet zgjedhore. Në vendimin e tij nr. 5, datë 04.04.2021, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor e ka sqaruar në mënyrë ezauruese këtë dileme, kur në pikën 27 të vendimit ka theksuar se *“**Kolegji vë në dukje se i njëjti rregull vlen dhe kur subjekti zgjedhor është koalicion, i cili kur regjistrohet, në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor, duhet të deklarojë partinë politike udhëheqëse të tij, e cila për nevoja të zbatimit të këtij Kodi përmbush të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përcakton Kodi për subjektet zgjedhore”***.

13. Arsyetimi konfirmohet edhe nga analiza në të kundërt e dispozitës. Nëse Komisioneri çmon se kjo fjali vlen vetëm për partitë që garojnë më vete në zgjedhje, atëherë përbri emrit të koalicionit nuk mund të qëndrojnë as sigla dhe as shkronjat nistore, as të partive pjesëmarrëse, as të

koalicionit. Nëse në fletën e votimit të miratuar nga Komisioneri është përcaktuar se përbri emrit të koalicionit “Bashkë Fitojmë” duhet të vendoset sigla dhe shkronjat nistore, atëherë emri i kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit duhet të vendoset, gjithashtu. **Ky është përcaktim ligjor, i cili nuk lë hapësirë për diskrecion.** Fjalja e dytë e pikës 3 të nenit 98 (*Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë*) nuk mund të copëtohet dhe prej saj të përzgjidhet dhe të vendoset në fletën e votimit përbri emrit të një koalicioni, sipas rastit, vetëm sigla, vetëm shkronjat nistore apo vetëm emri i kryetarit të partisë udhëheqëse.

14. Nga ana tjetër, kërkesa e ankuesit që për koalicionet të shënohen përbri emrit edhe shkronjat nistore të partive pjesëmarrëse të tij nuk ka bazë tek pika 3 e nenit 98 të Kodit Zgjedhor, e cila nuk e liston në fjalinë e dytë këtë opsion. I pyetur nga KAS-i, ankuesi nuk dha referencë ligjore për këtë kërkesë, por argumentoi se ky informacion shtesë është në dobi të zgjedhësve dhe qartëson më shumë të dhënat për koalicionet. KAS-i çmon se përfshirja e shkronjave nistore të partive pjesëmarrëse të koalicionit përbri emrit të tij, duke mos qenë detyruese sipas ligjit, hyn në sferën e diskrecionit të ligjshëm të Komisionerit, tek e cila KAS-i nuk mund të ndërhyjë.
15. Pala e interesuar, subjekti zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë”, paraqiti në seancë kërkesën që përbri koalicionit, në fletën e votimit, të pasqyrohet emri i deputetit Sali Berisha, si drejtues i koalicionit. Pala e interesuar deklaroi në seancë vullnetin për të pasur të shënuar në fletën e votimit “drejtuesin e koalicionit”, në pajtim me kërkesën e ankuesit, por insistoi se drejtuesi i koalicionit mund të caktohet vetëm nga partitë pjesëmarrëse të tij me vullnetin e tyre të lirë dhe nuk duhet të jetë domosdoshmërisht kryetari i partisë udhëheqëse të tij.
16. Shkresa e paraqitur në seancë nga përfaqësuesit e palës së interesuar me nr. 367 Prot., datë 19.04.2023 dhe që është nënshkruar në emër të koalicionit nga përfaqësuesi Endrit Brahimllari, pavarësisht se u prezantua si shprehje e vullnetit të partive pjesëmarrëse të koalicionit, nuk ka vlerën e një marrëveshjeje amenduese të marrëveshjes bazë të datës 15.03.2023, që të mund të merret në konsideratë nga KQZ-ja, në kuptimin e nenit 65 të Kodit Zgjedhor. Por edhe sikur të ishte e tillë, ajo nuk mund të sillte asnjë ndikim në çështjen në shqyrtim nga KAS-i, pa kaluar më parë në procedurë regjistrimi dhe amendimi të vendimit të Komisionerit nr. 178, datë 18.03.2023 (nëse lejohet nga ligji). Në trajtimin e çështjes, KAS-i nuk u bazua tek shkresa nr. 367 Prot., datë 19.04.2023, por në kërkesën e formalizuar nga përfaqësuesit në seancë të palës së interesuar.

17. Lidhur më këtë kërkesë, KAS-i konstaton se grupimi “Partia Demokratike” me kryetar z. Sali Berisha ka qenë subjekt themelues i koalicionit “Bashkë Fitojmë”, sikurse rezulton nga marrëveshja për krijimin e koalicionit e datës 15.03.2023. Gjithashtu KAS-i konstaton, se me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023, Komisioneri e ka përjashtuar nga koalicioni “Bashkë fitojmë” subjektin “Partia Demokratike” me kryetar z. Sali Berisha, duke i ndaluar *de facto* pjesëmarrjen në zgjedhje. Ligjërisht deputeti Sali Berisha dhe grupimi i tij politik nuk janë pjesë e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për pasojë deputeti Sali Berisha nuk mund të jetë ligjërisht drejtues i tij. I pyetur nga KAS-i, përfaqësuesi i palës së interesuar nuk dha asnjë të dhënë për ndonjë lidhje/raport juridik të deputetit Berisha me koalicionin ose me ndonjërin nga partitë pjesëmarrëse të tij, me të cilin të mund të justifikonte ligjërisht kërkesën e paraqitur.
18. Sipas marrëveshjes së koalicionit “Bashkë Fitojmë” të datës 15.03.2023, partia udhëheqëse e tij është Partia e Lirisë. *“Parti udhëheqëse e koalicionit, sipas parashikimeve të nenit 65 e vijues të Kodit Zgjedhor, është Partia e Lirisë”* thuhet në këtë marrëveshje. Kjo do të thotë se palët e marrëveshjes kanë pranuar me vullnet të lirë, në momentin e krijimit të koalicionit, se për zbatimin e nenit 65 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja duhet të njohë dhe pranojë Partinë e Lirisë dhe kryetarin e saj, z. Ilir Meta si përfaqësuesit zyrtarë të koalicionit. Në pajtim me jurisprudencën e Kolegjit Zgjedhor (vendimi nr. 5, datë 04.04.2021), kryetari i partisë që kërkon pika 3 e nenit 98 të Kodit Zgjedhor, nuk mund të jetë kush tjetër, përveç kryetarit të Partisë së Lirisë.
19. Përfundimisht KAS-i çmon se vendimet e Komisionerit nr. 361 dhe nr. 362 të datës 15.04.2023, me të cilat është miratuar përmbajtja e fletës së votimit për kandidatët për këshillin e bashkisë Tiranë dhe për këshillat bashkiakë të 60 bashkive të tjera, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023 janë nxjerrë në kundërshtim me nenin 11 të K.Pr.Administrative që parashikon parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit, si dhe me pikën 3 të nenit 98 të Kodit Zgjedhor, sa i takon mospasqyrimin të emrit të kryetarit të partisë udhëheqëse përbri emrit të koalicionit. Për këtë arsye këto vendime duhet të ndryshohen. Në fletët e votimit, sipas shtojcave bashkëlidhur vendimit, përbri emrit të subjektit zgjedhor “BASHKË FITOJMË”, përpara shkronjave nistore BF, të shkruhet emri i kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit ILIR METAJ, si dhe përbri emrit të subjektit zgjedhor “ALEANCA LIBERALE E DJATHTË”, përpara shkronjave nistore ALD, të shkruhet emri i kryetarit të partisë udhëheqëse të koalicionit ARTUR ROSHI.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21, pika 1, shkronja 'b', të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, në emër të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ,KAS-i me shumicë votash

V E N D O S I:

1. Pranimin e pjesshëm të kërkesës ankimore të paraqitur nga "Partia Demokratike e Shqipërisë", sa i takon pasqyrimin të emrit të kryetarëve të partive udhëheqëse të koalicioneve "Bashkë Fitojmë" dhe "Aleanca Liberale e Djathtë", në fletën e votimit.
2. Rrëzimin e kërkesës së "Partisë Demokratike të Shqipërisë" për sa i përket pasqyrimin të shkronjave nistore të partive përbërëse të koalicioneve përbri emrit të koalicionit përkatës.
3. Rrëzimin e kërkesës së palës së interesuar, koalicionit "Bashkë Fitojmë", për vendosjen e emrit të deputetit z. Sali Berisha në fletën e votimit si drejtues i koalicionit "Bashkë Fitojmë".
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Administrativ Brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Koli BELE - Relator

Elvin LAKO - Anëtar

Elvis ÇEFA - Anëtar (Kundër)

Ilirjan RUSMALI - Anëtar

Ledio BRAHO - Anëtar

MENDIM PAKICE

Në shqyrtimin e kërkesës ankimore nr. 50 të paraqitur nga subjekti zgjedhor “Partia Demokratike e Shqipërisë” përfaqësuar në seancë nga z. Indrit Sefa me objekt “Kundërshtimin e vendimeve të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 361 dhe nr. 362 të datës 15.04.2023”, unë anëtari në pakicë, duke mos qenë dakord me argumentet dhe konkluzionet e parashtruara nga shumica e anëtarëve të Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (në vijim KAS) parashtroj argumentet e mija për zgjidhjen e çështjes si më poshtë:

Përsa i përket legjitimitetit të ankimuesit, parashtroj:

1. Unë anëtari në pakicë jam i mendimit se KAS duhet të kishte vendosur mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore në fjalë për arsye se ankimuesit i mungon legjitimiteti për të kundërshtuar dy vendimet e KSHZ nr. 361 dhe nr. 362 të datës 15.04.2023. Më konkretisht, sikurse tashmë është fakt i ditur se KAS në mënyrë të përsëritur ka theksuar qëndrimin se e drejta e një subjekti për të paraqitur kërkesë ankimore, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar, si të çenuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme.
2. Kodi Zgjedhor në nenin 130, shkronja “b” parashikon se KAS merr vendim për pranimin ose mospranimin e kërkesës ankimore, pasi verifikon (...) legjitimitetin e ankuesit. E drejta e paraqitjes së ankimit lidhet me vërtetimin e ekzistencës së një interesi të ligjshëm të palës ankuese, e cila ngre një pretendim dhe që kërkon të dëgjohet mbi themelin e këtij pretendimi.
3. Referuar dispozitave të Kodit Zgjedhor, që kërkesa ankimore të jetë e vlefshme nga pikëpamja formale-procedurale duhet të plotësojë dy kushte themelore: a) interesi i ligjshëm; b) legjitimiteti për të vepruar. Interesi i ligjshëm, sipas arsyetimit të vendimit nr. 12, datë 24.06.2019 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, lind nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material dhe për këtë arsye, në esencë presupozon njohjen e cënimit të një interesi. Interesi i ligjshëm i lind palës nga domosdoshmëria për të mbrojtur interesin material të çenuar.

4. Në rastin konkret ankimesi, si parti politike konkurrese në zgjedhje është pasqyruar nga KSHZ si subjekt zgjedhor në fletën e votimit dhe për rrjedhojë atij vetë nuk i është cënuar asnjë interes. Mënyra e pasqyrimin nga KSHZ i çdo subjekti tjetër në fletën e votimit nuk cënon asnjë interes të ligjshëm të subjektit ankimes.
5. Vullneti që subjekti zgjedhor shpreh duke u regjistruar si i tillë në KQZ dhe për rrjedhojë duke u pasqyruar si i tillë në fletën e votimit, lidhet me interesin e tij të ligjshëm për të marrë pjesë në zgjedhje. Por interesi i ligjshëm për të marrë pjesë në zgjedhje nuk mund të çënojë të drejtën e subjekteve të tjera konkurrese në zgjedhje, përndryshe ky do të përbënte një interes të kundraligjshëm. E drejta e një subjekti zgjedhor, mbaron aty ky fillon e drejta e subjekteve të tjera zgjedhore. Në këtë kontekst kërkesa për mënyrën e identifikimit në fletën e votimit të një subjekti tjetër zgjedhor në këtë rast, nuk përbën interes të ligjshëm të subjektit zgjedhor PDSH. (Shih vendimin nr. 1, datë 09.05.2019 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor).
6. Është standart dhe praktikë zgjedhore që disa subjekte politike kanë përfaqësim të akredituar në KQZ dhe marrin pjesë në procesin administrativ të vendimmarrjes së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për aktet kryesore të procesit, sikundër është miratimi i fletës së votimit. Subjekti zgjedhor Partia Demokratike e Shqipërisë (PDSSH) ka ngritur përpara KAS një pretendim për mënyrën e paraqitjes në fletën e votimit të koalicionit “Bashkë Fitojmë” dhe kolacionit tjetër “Aleanca Liberale e Djathtë”, duke mos pasur ky subjekt (PD) asnjë “interes të ligjshëm” në kuptim të Kodit Zgjedhor, kundrejt koalicioneve të sipërcituara të cilët përbëhen nga disa subjekte zgjedhore, të cilët në fletën e votimit kanë emërtime dhe logo krejtësisht të ndryshëm nga ankuesi PDSH. Për efekt të kësaj gare zgjedhore, në fletën e votimit që do të kenë zgjedhësit në dispozicion në ditën e votimit, pasqyrimi i subjektit zgjedhor koalicioni “Bashkë Fitojmë” dhe koalicionit “Aleanca Liberale e Djathtë” janë qartësisht të dallueshme nga njëri-tjetri.
7. Duke qenë se objekt ankimesi është përcaktimi në fletën e votimit përbri emrit të koalicioneve zgjedhore edhe të emrave të kryetarëve të partive udhëheqëse të këtyre koalicioneve, subjekti ankues do të duhej të provonte ekzistencën e interesit të tij që cenohet nga vendimi të cilin ai kundërshton. Nga shpjegimet e përfaqësuesit të subjektit ankimes në

seancën paraprake përpara KAS, rezultoi se PDSH në fakt pretendon se ka interes në kundërshtimin e mënyrës së pasqyrimin në fletën e votimit të koalicionit zgjedhor “Bashkë Fitojmë” (i cili udhëhiqet nga Partia e Lirisë, në kuptim të nenit 65 të Kodit Zgjedhor) për shkak se gjatë fushatës elektorale të zhvilluar nga kandidatët e këtij koalicioni përmendet emri i Partisë Demokratike si pjesëmarrëse në koalicion. Në dukje, në këtë pikë mund të ketë një legjitimim formal të ankimesit, por në vlerësimin konkretisht të çështjes referuar përmbajtjes së fletës së votimit të miratuar me vendimet e KSHZ që kundërshtohen, PDSH nuk ka një legjitimitet substancial në ngritjen e këtij ankimi, pikërisht për arsyet e sipërcituara. Aq më pak ekziston ky legjitimitet në rastin e koalicionit tjetër zgjedhor “Aleanca Liberale e Djathtë”.

8. Pjesëmarrja e subjektit “PDSH” në fazën e shqyrtimit nga KSHZ të përmbajtjes së fletës së votimit nuk mund të shërbejë si shkak legjitimimi “automatik”, për efekt të ankimit në KAS. Në çdo rast do duhet që të vlerësohet paraprakisht, nëse ka apo jo interes të ligjshëm të ankuesit pavarësisht qënies si palë në shqyrtimin administrativ.
9. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, me Vendimin nr. 12, datë 24.06.2019, midis të tjerash përcakton se *“... sa i takon legjitimitet të paditësit, vlerësoj të theksoj se për të parashtruar përpara gjykatës një kërkim të caktuar është e nevojshme që të ketë interes. Ky interes është dobja personale për të kërkuar me anë të gjykatës njohjen ose rivendosjen e një të drejte të mohuar ose të shkelur. E drejta e një subjekti për të paraqitur një padi para gjykatës, lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me identifikimin e legjitimitetit të tij. Subjektet që ushtrojnë të drejtën për të ngritur padi para gjykatës, kanë detyrimin të provojnë legjitimitetin e tyre, duke provuar lidhjen e drejtpërdrejtë midis të drejtës apo interesit të pretenduar si të cënuar dhe veprimtarisë që kundërshtohet si e paligjshme...”* (Vendimi nr. 91, datë 19.03.2009 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë).
10. Po ashtu, përveç vendimit nr. 06, datë 07.02.2022, “Për mospranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 02, datë 05.02.2022 të Partisë Demokratike”, ky qëndrim është mbajtur në mënyrë konstante edhe nga KAS, në të paktën 5 (pesë) vendimmarrje të tjera të kohëve të fundit dhe që i përkasin kësaj periudhe zgjedhore. Konkretisht:

- vendimit nr. 53, datë 10.04.2023, që l përket kërkesës ankimore nr. 48, DATË 07.04.2023,
- vendimit nr. 40, datë 03.04.2023, që l përket kërkesës ankimore nr. 42, DATË 31.03.2023,
- vendimit nr. 32, datë 23.01.2023, që l përket kërkesës ankimore nr. 37, DATË 21.03.2023,
- vendimit nr. 22, datë 13.03.2023, që l përket kërkesës ankimore nr. 31, DATË 11.03.2023,
- vendimit nr. 20, datë 13.03.2023, që l përket kërkesës ankimore nr. 29, datë 11.03.2023,

Ndryshimi nga ana e KAS e kësaj praktike e cila tashmë mund të konsiderohet e konsoliduar, në vetvete përbën ushtrim të paligjshëm të diskrecionit administrativ në kuptim të pikës "ç" të nenit 11 të K.Pr.A, nga vetë KAS.

11. Përfundimisht, në vlerësimin e anëtarit në pakicë të KAS, ankimesit nuk i është shkelur ndonjë e drejtë dhe as cënuar interesi i ligjshëm nga vendimet nr. 361 dhe nr. 362 të datës 15.04.2023 të KSHZ. Për pasojë ai nuk legjitimohet në kundërshtimin e këtyre vendimeve dhe si e tillë ky ankimim nuk duhet të pranohej për shqyrtim nga KAS.

Lidhur me themelin e çështjes parashtror:

1. Pika 3 e nenit 98 të Kodit Zgjedhor detyron që **"Përbri emrit të partisë vendoset sigla, shkronja nistore dhe emri i kryetarit të partisë."** Fakti që ligji nuk ka bërë një urdhërim specifik për koalicionet zgjedhore, nënkupton se fjalia e dytë e pikës 3 të këtij neni është e vlefshme vetëm për partitë politike që garojnë më vete, dhe jo për koalicionet zgjedhore. Në këtë kontekst, referuar edhe faktit që në marrëveshjen e koalicionit "Bashkë Fitojmë" të depozituar në KQZ në momentin e regjistrimit, nuk është specifikuar fakti nëse do të ketë një emër të caktuar që do të shënohet në fletën e votimit përbri emrit të koalicionit, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përdorur diskrecion administrativ krejtësisht të ligjshëm në pranimin e kërkesës fillestare të përfaqësuesve të këtij koalicioni që emri në fletën e votimit të mos vendoset.
2. Është fakt botërisht i ditur se ka një konflikt të hapur prej kohësh lidhur me përfaqësimin real të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Vendimmarrja e mëparshme e KAS, e cila u pasua nga një vendim i KSHZ solli si pasojë regjistrimin në zgjedhjet e datës 14.5.2023 të PD me kryetar të komanduar z. Enkelejd Alibeaj. Në këto kushte, "Partia Demokratike" me kryetar z. Sali Berisha ka qenë subjekt themelues i koalicionit "Bashkë Fitojmë", sikurse rezulton nga marrëveshja për krijimin

e koalicionit e datës 15.03.2023. Pavarësisht faktit se me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023, Komisioneri nuk e ka lejuar subjektin “Partia Demokratike” me kryetar z. Sali Berisha të regjistrohet si pjesë e koalicionit zgjedhor “Bashkë Fitojmë”, kjo nuk do të thotë kurrësi që Komisioneri ka ndaluar z. Sali Berisha të jetë pjesë e këtij koalicioni apo qoftë edhe drejtues aktiv i tij, sikurse po ndodh realisht. Në këtë kontekst, në opinionin tim nuk qëndron konstatimi i bërë nga anëtarët në shumicë të KAS se: *“..me vendimin nr. 178, datë 18.03.2023, Komisioneri e ka përjashtuar nga koalicioni “Bashkë fitojmë” subjektin “Partia Demokratike” me kryetar z. Sali Berisha, duke i ndaluar de facto pjesëmarrjen në zgjedhje. Ligjërisht deputeti Sali Berisha dhe grupimi i tij politik nuk janë pjesë e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, për pasojë deputeti Sali Berisha nuk mund të jetë ligjërisht drejtues i tij.”.*

Është fakt i ditur botërisht se z. Sali Berisha dhe grupimi i tij politik janë në fakt pjesë e koalicionit “Bashkë Fitojmë”, por të papërfaqësuar zyrtarisht në të (koalicion) me një logo politike (partie), pra në fakt ata po marrin pjesë në zgjedhje dhe janë një realitet konkret politik. Për pasojë është krejtësisht e mundur dhe e ligjshme që të pranohet kërkesa dhe vullneti i këtij koalicioni, i materializuar nëpërmjet përfaqësuesve të tij në seancë, që emri i z. Sali Berisha të shënohet në fletën e votimit përbri emrit të koalicionit, kjo në interesin më të mirë të zgjedhësve dhe të zgjedhjeve.

3. Neni 46 i Kushtetutës, në pikën 1 të tij parashikon se *“1. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm.”.* Në nenin 1 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar parashikohet se *“Partitë politike janë bashkime vullnetare të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.”.* Në nenin 3 të po këtij ligji parashikohet se *“Partitë politike shqiptare janë pjesë e një sistemi të lirë e demokratik qeverisës në vend. Krijimi dhe veprimtaria e tyre është e lirë dhe e garantuar nga Kushtetuta.”.* Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 32, datë 21.06.2010, ka theksuar se *“... pluralizmi është një tërësi rrethanash ku pushteti politik është i shpërndarë në atë mënyrë që asnjë grup interesi ose klasë e caktuar shoqërore të mos mbizotërojë mbi të tjerët. Kushti bazë për pluralizmin janë zgjedhjet e lira, shumësia e interesave, lejimi i hapësirave për organizimin e mekanizmave të presionit ndaj organeve të pushtetit dhe një shtet që është i përgjegjshëm ndaj nevojave të qytetarëve. Në çdo sistem demokratik, përfaqësuesit e popullit*

në qeverisje zgjidhen përmes zgjedhjeve shumëpartiake, të lira, të barabarta dhe të ndershme” dhe “Konkurrimi i lirë ndërmjet partive është një shfaqje e drejtpërdrejtë e natyrës pluraliste të shoqërisë demokratike dhe është pikërisht mbrojtja e pluralizmit në jetën politike që ka kuptim për vetë ekzistencën e kësaj shoqërie. Gjykata thekson se çdo kufizim i drejtpërdrejtë ose i tërthortë mbi barazinë e partive në konkurrimin zgjedhor nuk duhet të ketë një pasojë diferencuese ose të përbëjë një trajtim preferencial për disa parti, ose të ndalojë pjesëmarrjen e partive politike në konkurrimin zgjedhor”. Në këtë kontekst, unë anëtar i KAS konfirmoj qëndrimin tim se asnjë institucion shtetëror nuk mund të cënojë pluralizmin politik dhe të drejtën e individëve për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur në organet e qeverisjes, ndaj vendimmarrja e KAS duhet të orientohet drejt një zgjidhje të drejtë dhe të paanshme të këtij rasti duke respektuar parimin e barazisë së armëve të palëve pjesëmarrëse në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

Anëtar në pakicë: Elvis Çefa